



# KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE PËR TEMAT POTENCIALE TË MARRËVESHJES PËRFUNDIMTARE KOSOVË - SERBI

NËNTOR, 2019





# **KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE PËR TEMAT POTENCIALE TË MARRËVESHJES PËRFUNDIMTARE KOSOVË - SERBI**

NËNTOR, 2019



**Përgatitën: Jeta Krasniqi, Violeta Haxholli dhe Eugen Cakolli**

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +383 (0)38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Vërejtje: Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Perspektiva Evropiane – ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë", i financuar nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

# PËRMBAJTJA

HYRJE - 6

METODOLOGJIA - 7

KONTEKSTI POLITIK MBI DIALOGUN KOSOVË-SERBI - 8

REZULTATET E HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK - 11

- 12** PYETJA 1 – A mendoni që qeveria e ardhshme duhet ti hap rrugë dialogut me Serbinë, duke pezulluar taksën?
- 14** PYETJA 2 - A e keni të qartë kuptimin e termit ‘korrigjim i kufijve’?
- 16** PYETJA 3: A e keni të qartë çfarë do të thotë/nënkupton “Asociacion i komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive”?
- 18** PYETJA 4: Cilat nga elementët e mëposhtme, sipas jush, duhet ti përfshijë marrëveshja Kosovë-Serbi?

PËRFUNDIMET - 22



# HYRJE

Hulumtimi i opinionit publik “Këndvështrimi i qytetarëve për temat potenciale të marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi” është i nënti me radhë i zhvilluar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) që nga viti 2016, me qëllim të nxjerrjes në pah të pikëpamjeve të qytetarëve rreth procesit të dialogut Kosovë-Serbi. Rezultatet e këtyre hulumtimeve të opinionit publik synojnë gjithashtu paraqitjen e këndvështrimit qytetar rreth pritshmërive të tyre rreth të ardhmes së dialogut Kosovë - Serbi, të cilat duhet të merren parasysh nga të gjithë akterët e përfshirë në kuadër të këtij procesi.

Që nga vendimi i Qeverisë së Kosovës, i datës 21 nëntor 2018, dialogu mes Kosovës dhe Serbisë vazhdon të jetë i pezulluar. Me gjithë insistimet e përfaqësuesve ndërkombëtar që palët t’i rikthehen tryezës së dialogut, nuk ka pasur lëvizje në pozicionet e palëve edhe një vit pas vendosjes së kësaj mase. Konkretisht, Serbia ka refuzuar që të rikthehet në dialog pa u pezulluar taksa 100% nga ana e Kosovës, gjë që kjo e fundit ka refuzuar t’a bëjë.

Raporti i hulumtimit të nëntë të opinionit publik reflekton qëndrimin e qytetarëve mbi zhvillimet politike veçanërisht taksën 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe BeH, tezën e korrigjimit të kufijve, asociacionin e komunave me shumicë serbe dhe elementet që duhet të përmbajë marrëveshja finale mes Kosovës dhe Serbisë. Në pjesën e parë të raportit pasqyrohen rezultatet e hulumtimit të opinionit publik lidhur me kuptueshmërinë e qytetarëve për tezën e korrigjimit të kufijve dhe asociacionin e komunave me shumicë serbe, si dhe qëndrimet e tyre rreth taksës 100% ndaj Serbisë dhe BeH. Ky hulumtim vë në pah gjithashtu qëndrimin qytetar rreth elementeve që duhet të përmbajë marrëveshja potenciale finale Kosovë - Serbi. Ndërsa në pjesën e dytë të raportit janë të paraqitura përfundimet nga të gjeturat e hulumtimit të opinionit publik.

Këto hulumtime synojnë promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë të përgjegjshme. Hulumtimi është organizuar në kuadër të projektit “Perspektiva Evropiane – ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë” financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës.





# METODOLOGJIA

Sondazhi është zhvilluar në nivel vendi duke përdorur metodën sistematike të rastësisë, me mostër prej 1070 të anketuarëve e dizajnuar për sigurimin e mostrës përfaqësuese, e shtresuar sipas etniciteteve: shqiptar, serb dhe minoritete jo-serbe, shtrirja sipas vendbanimeve (ubane/rurale) dhe përbërjes demografike. Sondazhi është realizuar në periudhën kohore 2 – 8 shtator 2019. Margjina e

gabimit është  $\pm 3\%$  në përzgjedhje për interval të konfidencës 95%. Përzgjedhja e amvisërisë është bërë duke shfrytëzuar metodën sistematike të rastësisë, si dhe zhvillimi i anketës me personin i cili e ka ditëlindjen e parë më të afërt i moshës mbi 18 vjet. Anketimi është realizuar ballë për ballë, ku anketuesi lexon pyetjet dhe shënon përgjigjen në pyetësor elektronik.







**REZULTATET  
E HULUMTIMIT  
TË OPINIONIT  
PUBLIK**

## PYETJA

# A mendoni që qeveria e ardhshme duhet ti hap rrugë dialogut me Serbinë, duke pezulluar taksën?

Më 21 nëntor, bëhet një vit që kur Qeveria e Kosovës e udhëhequr nga Ramush Haradinaj mori vendim për të vendosur taksë 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe BeH.<sup>1</sup> Kjo masë pati ndikim dhe në vet procesin e dialogut, pasi që Serbia refuzoi të marrë pjesë në dialog pa u hequr kjo masë. Që nga ajo kohë Qeveria e Kosovës ishte përballuar me kërkesa të vazhdueshme dhe presion nga bashkësia ndërkombëtare që të pezullonte taksën në mënyrë që procesi i dialogut të rifillonte. Taksa kishte shkaktuar edhe përçarje në mes të partnerëve të koalicionit qeverisës, duke qenë se PDK favorizonte pezullimin e taksës, ndërsa AAK vlerësonte që taksa duhet të mbetet në fuqi. Kryetari i PDK-së z. Kadri Veseli kishte propozuar që taksa të pezullohej përkohësisht për 120 ditë, si masë mirëbesimi ndaj SHBA-ve dhe BE-së.<sup>2</sup> Megjithatë, deklaratat e përfaqësuesve të PDK-së lidhur me taksën kishin ndyshuar sidomos gjatë fushatës zgjedhore, gjatë së cilës ata kishin shprehur përkrahje për vazhdimin e mbajtjes së kësaj mase.<sup>3</sup> Ndërsa subjektet politike LDK dhe LVV kishin vlerësuar se ndaj Serbisë duhet të vendoset reciprociteti i plotë ndërsa taksën e kishin vlerësuar si vendim të marrë nga Qeveria e kaluar pa analizë të mirëfilltë.

Faktori ndërkombëtar filloi të ushtroj presion edhe ndaj

Serbisë për heqjen dorë nga fushata ndërkombëtare kundër shtetit të Kosovës. Kjo ishte artikulluar edhe nga i dërguari special i Departamentit të Shtetit për Ballkanin Perëndimor z. Matthew Palmer i cili kishte deklaruar se Kosova duhet të pezullojë taksën, por edhe Serbia duhet të ndalojë fushatën e saj për 'çnjohjen' e Kosovës.<sup>4</sup>

Aktualisht Kosova ndodhet para krijimit të institucioneve të reja qeverisëse dhe çështja e taksës do të jetë një ndër temat të cilat mbeten të ndërlidhura me procesin e dialogut dhe do të duhet të adresohet nga Qeveria e re. Për këtë arsye, në këtë sondazh qytetarët janë pyetur lidhur me qëndrimin e tyre se a duhet qeveria e ardhshme ti hap rrugë dialogut me Serbinë, duke pezulluar taksën?

Përgjigjia e 59% të qytetarëve të anketuar kanë vlerësuar se Qeveria nuk duhet të pezullojë taksën për t'i hapur rrugë dialogut, ndërsa 34% të tyre janë të mendimit se kjo duhet të ndodhë. Se nuk e dinë se çfarë vendimi duhet të marrë Qeveria lidhur me këtë çështje, janë përgjigjur 8% e qytetarëve të anketuarëve.

Sipas përkatësisë etnike, shpërfaqen dallime në përgjigjet e të anketuarëve nga komuniteti shqiptar, komuniteti serb dhe komunitetet e tjera jo shumicë. Se Qeveria e Kosovës duhet të pezullojë taksën për t'i hapur rrugë dialogut men-


1 Shih vendimin e Qeverisë të datës 21 nëntor 2018 në, <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/11/Lista-e-mallrave-te-perjashtuara.pdf>

2 Koha Net, "Veseli propozon që taksa të pezullohet për 120 ditë", 28 janar 2019 në, <https://www.koha.net/arberi/142112/veseli-propozon-qe-taksa-te-pe-zullohet-per-120-dite/>

3 Shih deklaratën e Enver Hoxhaj të datës 6 shtator 2019 në, <https://zeri.info/zgjedhjet-2019/285525/partite-politike-thone-se-taksa-mbetet-edhe-pas-zgjedhjeve/>


4 Shih deklaratën e Matthew Palmer: Serbia t'i ndalë çnjohjet, Kosova ta heqë taksën, e datës 3 shtator 2019 në, <https://klankosova.tv/matthew-palmer-serbia-ti-ndale-cnjohjet-kosova-ta-heqe-taksen/>

Përgjigjia e **59%** të qytetarëve të anketuar kanë vlerësuar se Qeveria nuk duhet të pezullojë taksën për t'i hapur rrugë dialogut, ndërsa **34%** të tyre janë të mendimit se kjo duhet të ndodhë. Se nuk e dinë se çfarë vendimi duhet të marrë Qeveria lidhur me këtë çështje, janë përgjigjur **8%** e qytetarëve të anketuarëve.



dojnë 86% e të anektuarëve nga komuniteti serb, kundrejt 32% të anketuarëve nga komuniteti shqiptar dhe 24% e anketuarëve nga komunitetet e tjera jo shumicë, që ndajnë të njëjtin mendim. Ndërsa, se taksa duhet të vazhdojë

të mbetet në fuqi, mendojnë 61% e të anketuarëve nga komuniteti shqiptar, 56% e anketuarëve nga komunitetet e tjera jo shumicë dhe 10% e të anketuarëve nga komuniteti serb.




## PYETJA

### A e keni të qartë kuptimin e termit 'korrigjim i kufijve'?

Kur idea e 'korrigjimit të kufijve' ishte shpalosur në opinion nga Presidenti Thaçi në vitin 2017, kishte pasur paqartësi lidhur me atë se çfarë nënkupton termi 'korrigjim i kufijve'. Presidenti Thaçi insistonte se kjo nënkuptonte bashkimin e Luginës së Preshevës me Republikën e Kosovës ndërsa në opinion ishin ngritur shqetësime se korrigjimi i kufijve nënkupton shkëmbimin e territoreve mes Kosovës dhe Serbisë, konkretisht shkëmbimin e pjesës veriore të Kosovës me Luginën e Preshevës në Serbi. As Presidenti Thaçi nuk kishte arritur të qartësonte se pse Serbia do të pranonte ti jepte Kosovës pjesë të territorit të saj, pa kërkuar edhe ajo pjesë të territorit të Kosovës. Ndërsa nuk munguan dhe elaborimet e tezave të tjera të cilat i kontribuan interpretimeve të ndryshme të ndërlidhura me këtë nocion.


Duke pasur parasysh dykuptimësinë që mund të kishte teza e 'korrigjimit të kufijve' KDI ka pyetur qytetarët e Kosovës se a e kanë ata të qartë kuptimin e termit 'korrigjim i kufijve'. Lidhur me këtë, 45% të anketuarëve janë përgjigjur se e kanë të qartë kuptimin e këtij termi, kundrejt 31% të anketuarëve që e kanë deri diku të qartë dhe 20% të anketuarëve që janë shprehur se e kanë të paqartë se çfarë nënkupton termi 'korrigjim i kufijve'. Ndërsa, vetëm 3% e anketuarëve kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.

Lidhur me këtë, **45%** të anketuarëve janë përgjigjur se e kanë të qartë kuptimin e këtij termi, kundrejt **31%** të anketuarëve që e kanë deri diku të qartë dhe **20%** të anketuarëve që janë shprehur se e kanë të paqartë se çfarë nënkupton termi 'korrigjim i kufijve'. Ndërsa, vetëm **3%** e anketuarëve kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.



Përgjigjet sipas përkatësisë etnike kanë shfaqur dallime në mes komuniteteve sa i përket kuptueshmërisë së tezës së 'korrigjimit të kufijve'. Kështu, 47% e anketuarëve nga komuniteti shqiptar janë shprehur se e kanë të qartë kuptimin e 'korrigjimit të kufijve', kundrejt vetëm 20% e të anketuarëve nga komuniteti serb dhe 23% e të anketuarëve nga komunitetet e tjera jo shumicë kanë ndarë të njëjtin mendim.

Ndërsa, 51% e anketuarëve nga komuniteti shqiptar, 52% nga komuniteti serb dhe 73% nga komunitetet e tjera jo shumicë, janë shprehur në përgjithësi që nuk e kanë plotësisht të qartë këtë koncept duke variuar nga përgjigja që e kanë deri diku të qartë tek ajo që e kanë të paqartë. Në këtë pyetje kanë refuzuar të përgjigjen 29% e të anketuarëve nga komuniteti serb, 5% nga komunitetet e tjera jo shumicë dhe 2% nga komuniteti shqiptar.



## PYETJA

# A e keni të qartë çfarë do të thotë/nënkupton “Asociacioni i komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive”?

Marrëveshja Kosovë - Serbi për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe ishte arritur në Bruksel qysh në vitin 2013 në kuadër të Marrëveshjes së Parë të Parimeve për Normalizimin e Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.<sup>5</sup> Ndërsa dy vite më pas në vitin 2015, palët ishin dakorduar për parimet e përgjithshme të Asociacionit<sup>6</sup>, të cilat përcaktonin elementet kryesore për themelimin e këtij mekanizmi.<sup>7</sup> Të dy këto marrëveshje ishin pritur me kritika të mëdha në Kosovë, për të cilat ishin ngritur shqetësime për mundësinë e krijimit të një niveli të tretë të qeverisjes që mund të rrezikonte karakterin unitar të shtetit të Kosovës. Atë botë ishin organizuar edhe protesta nga një pjesë e spektrit politik ndërsa brenda Kuvendit të Kosovës ishte hedhur edhe gaz lotsjellës. Pas bllokadës institucionale që ishte krijuar si rezultat i kundërshtimit të kësaj marrëveshjeje, Presidentja e atëhershme znj. Atifte Jahjaga i ishte drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të interpretuar marrëveshjen e vitit 2015 për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Gjykata kishte konkluduar se parimet e elaboruara në përmbajtjen e marrëveshjes për Asociacionin nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës dhe kishte konstatuar që edhe akti i Qeverisë dhe statuti për

themelimin e Asociacionit duhej të ishin në pajtueshmëri me kapitujt përkatës kushtetues.<sup>8</sup>

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese pati ndikim në disponimin e përfaqësuesve serb që të ndërmarrin hapat e nevojshëm për themelimin e Asociacionit në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Si rezultat ky mekanizëm nuk u themelua sot e asaj dite, megjithatë nuk është përjashtuar mundësia që kjo çështje të jetë pjesë e diskutimeve në fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi, kurdo që vazhdon ky proces, dhe me këtë rast Asociacionit potencialisht t'i mveshen kompetenca ekzekutive. Ka pasur interpretime të ndryshme se si duhet të duket ky asociacion, çfarë kompetencash duhet të ketë të një organizate jo qeveritare apo të një mekanizmi vendimmarrës me fuqi ekzekutive. Diskutimet kanë adresuar dhe ndikimin që Asociacioni i komunave me shumicë serbe mund të ketë në funksionimin e brendshëm unitar të shtetit të Kosovës, të marrëdhënieve që do të krijonte në mes komunitetit serb në Kosovë dhe shtetit të Serbisë si dhe funksionimit të shtetit të Kosovës si shoqëri multietnike. Duke pasur parasysh këtë, KDI ka dashur të dijë mendimin e qytetarëve lidhur me Asociacionin, përkatësisht se sa e


5 Shih Marrëveshjen e Parë të Parimeve për Normalizimin e Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë të datës 19 prill 2013 në, [http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes\\_19prill2013\\_HGXf5EDTG4.pdf](http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_19prill2013_HGXf5EDTG4.pdf)

6 Vlen të theksohet se vetëm marrëveshja e parë e parimeve është e ratifikuar në Kuvend të Kosovës, ndërsa Parimet e Asociacionit nuk u sollën për ratifikim, duke u pretenduar se ishin derivat i marrëveshjes bazë.

7 Shih marrëveshjen për parimet themelore të Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe të datës 25 gusht në, [http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes\\_25gusht2015\\_EVDK4S6aE9.pdf](http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_25gusht2015_EVDK4S6aE9.pdf)


8 Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me marrëveshjen e Asociacionit të datës 23 dhjetor 2015 në, [http://gjk-ks.org/ep-content/uploads/vendimet/gjk\\_ko\\_130\\_15\\_shq.pdf](http://gjk-ks.org/ep-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_shq.pdf)

Lidhur me këtë **39%** e qytetarëve janë përgjigjur se e kanë të qartë çfarë nënkupton ky term kundrejt **29%** të qytetarëve që kanë deklaruar se e kanë të paqartë se çfarë nënkupton Asociacioni me kompetenca ekzekutive ndërsa, **27%** janë shprehur se e kanë deri diku të qartë se çfarë nënkupton ky emertim. Kurse, **4%** e qytetarëve kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.



kanë ata të qartë se çfarë nënkupton Asociacioni i komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive. Sa i përket ndarjes etnike, 41% e anketuarëve nga komuniteti shqiptar janë shprehur se e kanë të qartë kuptimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive, kundrejt 26% të qytetarëve nga komuniteti serb dhe 17% të qytetarëve nga komunitetet e tjera jo shumicë që kanë ndarë të njëjtin qëndrim. Se e kanë të paqartë kuptimin e këtij termi janë deklaruar 48% të anketuarëve nga komunitetet e tjera jo shumicë kundrejt, 29% të anketuarëve nga komuniteti

shqiptar dhe serb të cilët janë shprehur ngjashëm. Ndërsa, 31% të anketuarëve nga komunitet e tjera jo shumicë, 28% e anketuarëve nga komuniteti shqiptar dhe 19% e anketuarëve nga komuniteti serb kanë deklaruar se e kanë deri diku të qartë se çfarë nënkupton Asociacioni i komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive. Në këtë pyetje kanë refuzuar të përgjigjen 26% e anketuarëve nga komuniteti serb, 5% e anketuarëve nga komunitetet e tjera jo shumicë dhe 3% e anketuarëve nga komuniteti shqiptar.



## PYETJA

# Cilat tema, sipas jush, duhet të përfshihen në kuadër të marrëveshjes Kosovë-Serbi?

Që nga fillimi i procesit të dialogut në mars të vitit 2011, Kosova dhe Serbia kanë arritur rreth 33 marrëveshje duke përfshirë marrëveshjet bazë, konkluzat e dakorduara, planet e zbatimit dhe marrëveshjet që janë rinegociuar.<sup>9</sup> Këto marrëveshje janë arritur në disa fusha duke përfshirë, regjistrat civil, regjistrat kadastral, menaxhimin e integruar të kufijve, diplomat, fushën e drejtësisë, energjisë, telekomunikacionit, të policisë, bashkëpunimin rajonal, shpërbërjen e disa prej strukturave paralele serbe në Kosovë, vulat doganore dhe fusha të tjera. Megjithatë, mbeten shumë çështje të cilat ende nuk janë adresuar në procesin e dialogut. Lidhur me këtë, në vitin 2016, ish-kryenegociatorja për dialogun znj. Edita Tahiri pati deklaruar se në dialog pritej të diskutoheshin tema si reparacionet e luftës, çështja e të pagjeturve, kthimi i fondit pensional, suksesioni etj.<sup>10</sup> Në anën tjetër edhe ish-Kryeministri i Kosovës z. Ramush Haradinaj pati publikuar një draft marrëveshje e cila përfshinte çështjet, që sipas tij, do duhej të përmbante marrëveshja përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë.<sup>11</sup> Aktualisht procesi i dialogut vazhdon të mbetet i pezulluar dhe e ardhmja e këtij procesi mbetet e paqartë. Po ashtu, nuk dihet se cilat do të jenë temat që do të diskutohen në kuadër të këtij procesi dhe të cilat mund të jenë pjesë e një marrëveshjeje potenciale gjithëpërfshirëse ligjërisht të obligueshme në mes Kosovës dhe Serbisë.

Lidhur me këtë, KDI ka dashur të dijë mendimin e qytetarëve të Kosovës rreth temave të cilat sipas vlerësimit duhet t'i përfshijë marrëveshja Kosovë-Serbi. Një ndër çështjet që qytetarët kanë vlerësuar si kryesore është ranguar çështja e të pagjeturve përkatësisht me 71% mbështetje. Kurse, në përqindje mjaft të lartë janë ranguar krimet e luftës (60%) dhe dëmshpërblimet e luftës (59%) që sipas qytetarëve po ashtu duhet të jenë elemente përbërëse të marrëveshjes Kosovë - Serbi. Më tutje, qytetarët e konsiderojnë edhe kërkimfaljen si pjesë të rëndësishme të marrëveshjes me 56% dhe kthimin e fondit pensional me 41%. Kurse, me 38% është vlerësuar njohja reciproke, që sipas qytetarëve duhet të jetë po ashtu një nga elementet e kësaj marrëveshjeje.


Në anën tjetër, në shkallën prej 25% e më poshtë qytetarët kanë vlerësuar se duhet të jenë pjesë e kësaj marrëveshjeje çështjet si: kthimi i artifakteve (25%), anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare (23%), korrigjimi i kufijve (20%), bashkëpunimi ekonomik (14%), demarkimi i kufirit mes dy shteteve (13%), avansimi i të drejtave të komunitetit shqiptar në Serbi (12%), bashkëpunimi i të rinjëve (9%), suksesioni (8%), bashkëpunimi kulturor (7%), avansimi i të drejtave të komunitetit serb në Kosovë (6%) dhe asociacioni i komunave me shumicë serbe (5%).

9 Të gjitha marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, mund t'i gjeni te <http://votaime.org/Public/Dialog>

10 Insajderi, Deklarata e Edita Tahirit: "Pesë temat e reja që mund të diskutohen në Bruksel" <https://insajderi.com/pese-temat-e-reja-qe-mund-te-diskutohen-ne-bruksel/>

11 Marrëveshja Gjithëpërfshirëse ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhjetor 2018 në, [http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/raftMarreveshjaGjithepershiresendermjetKosovesdheSerbise\\_zGN5KTvtm\\_RjV5CWhpTz.pdf](http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/raftMarreveshjaGjithepershiresendermjetKosovesdheSerbise_zGN5KTvtm_RjV5CWhpTz.pdf)





Në anën tjetër, në shkallën prej **25%** e më poshtë qytetarët kanë vlerësuar se duhet të jenë pjesë e kësaj marrëveshje çështjet si, kthimi i artefakteve (**25%**), anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare (**23%**), korrigjimi i kufijve (**20%**), bashkëpunimi ekonomik (**14%**), demarkimi i kufirit mes dy shteteve (**13%**), avansimi i të drejtave të komunitetit shqiptar në Serbi (**12%**), bashkëpunimi i të rinjëve (**9%**), suksesioni (**8%**), bashkëpunimi kulturor (**7%**), avansimi i të drejtave të komunitetit serb në Kosovë (**6%**) dhe asociacioni i komunave me shumicë serbe (**5%**).

Sipas përkatësisë etnike janë shpërfaqur dallime në përgjigjet që kanë dhënë qytetarët nga komuniteti shqiptar, komuniteti serb dhe komunitetet e tjera jo shumicë. P.sh përderisa qytetarët nga komuniteti shqiptar me 73% dhe qytetarët e komuniteteve të tjera jo shumicë me 64%, e kanë ranguar çështjen e të pagjeturve si një nga elementet kryesore që duhet të përfshijë marrëveshja Kosovë - Serbi, qytetarët komunitetit serb kanë ranguar avansimin e të drejtave të komunitetit serb në Kosovë, me 60%, si një nga elementet kryesore që sipas tyre duhet të përmbajë kjo marrëveshje. Në anën tjetër përderisa qytetarët nga komuniteti shqiptar e kanë ranguar kërkimfaljen në nivel prej 59% si një nga elementet që duhet të përfshihen në marrëveshjen Kosovë

	<b>SHQIPTAR</b>
Të pagjeturit	<b>73%</b>
Dënimi për krimet e luftës	<b>62%</b>
Dëmshpërblimet e luftës	<b>61%</b>
Kërkimfalja	<b>59%</b>
Kthimi i fondit pensional	<b>42%</b>
Njohja reciproke	<b>40%</b>
Kthimi i artifaktave, librave	<b>26%</b>
Anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare	<b>23%</b>
Korigjimi i kufinjëve	<b>21%</b>
Bashkëpunimi ekonomik	<b>13%</b>
Demarkimi i kufirit Kosovë-Serbi	<b>14%</b>
Avansimi i të drejtave të komunitetit shqiptar në Serbi	<b>11%</b>
Bashkëpunimi i të rinjëve	<b>9%</b>
Suksesioni	<b>9%</b>
Bashkëpunim kulturor	<b>6%</b>
Avansimi i të drejtave të komunitetit serb në Kosovë	<b>4%</b>
Asociacioni i komunave me shumicë serbe	<b>3%</b>
Tjetër	<b>0%</b>

- Serbi, qytetarët nga komuniteti serb e kanë vlerësuar këtë element me vetëm 11%. Edhe tek njohja reciproke vërehet dallim i theksuar mes qytetarëve të komunitetit shqiptar dhe atij serb, të parët me 40% vlerësojnë se njohja duhet të jetë një nga elementet përbërëse të marrëveshjes, ndërsa të dytit me vetëm 7%. Si element të rëndësishëm të marrëveshjes, qytetarët nga komuniteti serb me 47% e konsiderojnë se çështje përbërëse e marrëveshjes duhet të jetë asociacioni i komunave me shumicë serbe, për dallim nga qytetarët e komunitetit shqiptar të cilët e kanë vlerësuar në vetëm 3% si element që duhet të përfshihet në kuadër të marrëveshjes së dialogut Kosovë-Serbi.

<b>SERB</b>	<b>TË TJERË</b>
<b>32%</b>	<b>64%</b>
<b>34%</b>	<b>46%</b>
<b>21%</b>	<b>52%</b>
<b>11%</b>	<b>34%</b>
<b>12%</b>	<b>47%</b>
<b>7%</b>	<b>24%</b>
<b>4%</b>	<b>29%</b>
<b>8%</b>	<b>19%</b>
<b>5%</b>	<b>18%</b>
<b>22%</b>	<b>20%</b>
<b>7%</b>	<b>8%</b>
<b>15%</b>	<b>16%</b>
<b>14%</b>	<b>12%</b>
<b>2%</b>	<b>12%</b>
<b>20%</b>	<b>13%</b>
<b>60%</b>	<b>14%</b>
<b>47%</b>	<b>4%</b>
<b>0%</b>	<b>0%</b>



# 4. PËRMBLEDHJE:

## Rezultatet e hulumtimit të këtij opinioni publik shpërfaqin këto të gjetura:

- 1** Shumica e qytetarëve (59%) mendojnë që qeveria e ardhshme nuk duhet të pezullojë taksën për t'i hapur rrugë dialogut me Serbinë. Megjithatë, sipas përkatësisë etnike këtë mendim e ndajnë 61% e të anketuarëve nga komuniteti shqiptar, 56% e të anketuarëve nga komunitetet e tjera jo shumicë dhe vetëm 10% e të anketuarëve nga komuniteti serb.
- 2** Rreth 45% e të anketuarëve janë shprehur se e kanë të qartë se çfarë nënkupton termi "korrigjim i kufijve". Ndërsa, 31% të anketuarëve janë shprehur që e kanë deri diku të qartë dhe 20% të anketuarëve që janë shprehur se e kanë të paqartë se çfarë nënkupton termi 'korrigjim i kufijve'. Sipas përkatësisë etnike këtë term e kanë të qartë 47% e të anketuarëve nga komuniteti shqiptar, 20% të anketuarëve nga komuniteti serb dhe 23% të anketuarëve nga komunitetet e tjera jo shumicë.
- 3** Janë 39% e qytetarëve të cilët janë shprehur se e kanë të qartë se çfarë do të thotë "Asociacion i komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive". Ndërsa 29% e qytetarëve të anketuar që kanë deklaruar se e kanë të paqartë dhe 27% e tyre janë shprehur se e kanë deri diku të qartë se çfarë nënkupton ky term. Në baza etnike ky term është i qartë në nivel më të lartë tek qytetarët nga komuniteti shqiptar me 41%, kundrejt 26% të qytetarëve nga komuniteti serb dhe 17% e qytetarëve nga komunitetet e tjera jo shumicë.
- 4** Sipas qytetarëve të anketuar, disa nga elementet më të rëndësishme që duhet të përfshijë marrëveshja Kosovë - Serbi janë të pagjeturit (71%), dënimet për krime të luftës (60%), dëmshpërblimet e luftës (59%) dhe kërkimfalja (56%). Megjithatë, janë shpërfaqur dallime në mes qytetarëve nga komunitetet e ndryshme lidhur me elementet që duhet të përmbajë marrëveshja Kosovë - Serbi







Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Federal Department of Foreign Affairs FDFA**